



Buletini

- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- * Aktivitetet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial
 - * Aktivitetet tjera

Qershor 2019

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Shpronësimi dhe caktimi i kompensimit

Më 03 qershor 2019, Akademia e Drejtësisë organizoj trajnimin me temë: “Shpronësimi dhe caktimi i kompensimit” në kuadër të PTV-së.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me procedurën e shpronësimit, identifikimin e kushteve paraprake për shpronësim dhe kriterëve të cilat zbatohen për shpronësim.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan: Kushtet ligjore për shpronësim; procedura e shpronësimit në rastet kur organ shpronësues është Qeveria apo Komuna; vendimi preliminar dhe përfundimtar për shpronësim si dhe mjetet juridike. Në pjesën e dytë u trajtuan mënyrat dhe kriteret për caktimin e kompensimit në rastet e shpronësimit.

Që në fillim u potencua se instituti juridik i shpronësimit lejon mundësinë që pronari të mund të zhvishet nga e drejta e pronësisë vetëm nën kushtet e parapara me ligj me kusht që shpronësimi të bëhet për qëllim të interesit të përgjithshëm. Meqenëse shpronësimi në praktikë paraqitet shumë shpesh, zbatimi i rregullt i dispozitave të Ligjit për Shpronësimin garanton të drejtën pronësore të pronarëve, prona e të cilëve shpronësohet për interes të përgjithshëm publik. Andaj, njohuritë e fituara dhe zberthimi i këtij institut juridik, do t'i kontribuoj edhe unifikimit të praktikës gjyqësore në Republikën e Kosovës.

Në vazhdim u theksua se shpronësimi i pronës së paluajtshme në mënyrë specifike është i rregulluar me Ligjin nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, i shpallur më 23.04.2009. Prona private është kategori e garantuar dhe e mbrojtur me akte ndërkombëtare, të cilat garantojnë se prona private është e pacenueshme dhe mund të kufizohet vetëm për interes publik dhe nën kushtet e përcaktuara me Ligj. Një ashtu edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës parashihet mbrojtja e saj nga çdo ndërhyrje arbitrare dhe se askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës, mund ta bëjë eksproprijimin e pronës, nëse ky eksproprijim është i autorizuar me Ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin apo për personat prona e së cilëve u është eksproprijuar.

Më tej u konkludua se konform LPJK-së, në procedurën për caktimin e lartësisë së kompensimit për paluajtshmërinë e eksproprijuar gjykata e cakton lartësinë e shpërblimit për paluajtshmërinë e eksproprijuar kur shfrytëzuesi i eksproprijimit dhe pronari i mëparshëm para organit kompetent të administratës nuk kanë arritur marrëveshje për kompensim për paluajtshmërinë e eksproprijuar.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e gjykatave themelore, gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, bashkëpunëtorët profesional në gjykata si dhe zyrtarët e Ministrisë së Financave që merren me procedurat e kompensimit pranë organit shpronësues.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe efektet juridike të tyre

Më 06 qershor 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV-së, ka realizuar trajnimin me temë “E drejta për liri dhe siguri - neni 5 i KEDNJ”. Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me rolin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe vendimeve të saj, natyrën juridike, efektin si dhe mënyrën e përmbartimit të tyre.

Në pjesën e parë të këtij trajnimi u trajtuan: Roli i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe vendimeve të saja, natyra juridike e këtyre vendimeve dhe efektet e tyre. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan: Llojet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe përmbartimi i tyre.

Që në fillim u potencua se në praktikën e Gjykatës Kushtetuese dallohen disa lloj vendimesh në varësi nga qëndrimi që ato mbajnë ndaj normave që kontrollojnë. Po kështu, edhe proceset që kryhen nëpërmjet vendimeve mund të kenë natyra të ndryshme. Roli i Gjykatës Kushtetuese qëndron pikërisht në fuqinë e vendimeve të saj. Mirëpo realizimi dhe zbatimi praktik i vendimeve gjyqësore kushtetuese është një çështje me rëndësi të veçantë dhe për këtë u diskutua në mënyrë të gjithanshme.

Në këtë trajnim u potencua se siç përcaktohet edhe me Kushtetutë, Gjykata Kushtetuese e Kosovës është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

Më tej u potencua se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës dhe përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi

i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktoj dëme të riparueshme.

Gjithashtu me Kushtetutë është përcaktuar se Gjykata Kushtetuese, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me vendim të Gjykatës Kushtetuese, shfuqizimi i ligjit, i aktit ose i veprimit hyn në fuqi në ditën e publikimit të vendimit të Gjykatës.

Më tej u veqta mendimi se: Siç vërehet edhe nga përmbajtja neni 53 i Kushtetutës së Kosovës obligon gjyqtarët që në vendimet e tyre gjyqësore të reflektojnë frymën interpretative të GJEDNJ në Strasburg Ndonëse kjo praktikë e referimit në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së nga gjykatat e rregullta është akoma në fazën fillestare, Gjykata Kushtetuese e Kosovës në mënyrë konsistente i është referuar kësaj praktike gjyqësore kur është konfrontuar me çështje-shqyrtimi i të cilave ka qenë kufizimi i lirive dhe të drejtave kushtetuese.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit teorik, duke u bazuar në raste studimore dhe nga praktika gjyqësore duke u shoqëruar me diskutime interaktive të lehtësuara nga trajnuesit, përmes analizës dhe shtjellimeve të tematikës, me fokus në zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Përfitues ishin: gjyqtarët e të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës dhe bashkëpunëtorët profesional.



Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale: 6-8 qershor 2019

Më 6-8 qershor 2019, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Departamentin Ligjor të SHBA-së/OPDAT, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë “Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që përfituesit e trajnimit të njihen me dispozitat e reja ligjore dhe ato që kanë pësuar ndryshime esenciale me qëllim të zbatimit të drejtë dhe më të lehtë në praktikë.

Ky trajnim tre ditorë ka trajtuar ndryshimet e dispozitave të përgjithshme të Kodit Penal, duke analizuar ndryshimet që kanë të bëjnë me veprat penale kundër shërbimeve komunale, veprat penale të korrupsionit zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare dhe nenet e reja që janë përfshirë në Kodin Penal i cili ka hyrë në fuqi. Paraprakisht gjatë trajnimit u trajtuan edhe

ndryshimet që priten të bëhen në Kodin e Procedurës Penale, siç është mbrojtja e detyruar, mbrojtësi me shpenzime publike, kur mbrojtja nuk është e detyruar dhe të drejtat e të dëmtuarit ose viktimës, hudhja e kallëzimit penal, e drejta për të apeluar hudhjen, masat e veçanta hetimore, marrja në pyetje në procedurë paraprake, deklarata në procedurë paraprake dhe mundësia hetuese e veçantë. Po ashtu u diskutua dispozita e re që rregullon suspendimin e personit zyrtar nga detyra, qasja publike në aktakuzë dhe publikimi i aktgjykimit si dhe gjykimi në mungesë dhe seanca për caktimin e dënimit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë, prokurorë, avokat dhe mbrojtës të viktimave nga regjioni i Gjilanit.



Lufta kundër Trafikimit me qenie njerëzore

Me 10-11 qershor 2019, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin e Organizatës Evropiane për Ligjin Publik ELPO, realizoj punëtorinë dy-ditore me temë: “Lufta kundër Trafikimit me qenie njerëzore”



Qëllimi i kësaj punëtorie ishte luftimi dhe zbatimi i drejtë i ligjit në fuqi sa i përket këtyre veprave penale.

Në ditën e parë janë trajtuar kryesisht aspektet ligjore të kësaj vepre si dhe të kuptuarit e

viktimës dhe perspektivat e viktimës. Në ditën e dytë fokus të veçantë kishte mbrojtja e viktimës para dhe gjatë zhvillimit të procesit penal, mbështetja, rehabilitimi i viktimës dhe ri-integrimi i saj në shoqëri.

Me rastin e kësaj punëtorie përmes rasteve praktike u vu në pah se trafikimit me qenie njerëzore është dukuri e përhapur dhe më fitimprurëse e krimit të organizuar, duke arritur dimensione të njëjta me trafikimin e drogës dhe të armëve. Andaj, u kërkua që pjesëmarrësit të kuptojnë drejt elementet e veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore dhe të njohin format e shfrytëzimit të viktimave të trafikimit me njerëz në mënyrë që të ketë rezultate në luftimin e këtyre veprave.

Përfitues të kësaj punëtorie ishin gjyqtarët, prokurorët, bashkëpunëtorët profesional si dhe zyrtarët ligjor nga gjykatat dhe prokuroritë e Kosovës.



Procedura dhe objekti i Konfliktit Administrativ

Më 11 qershor 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV-së, ka realizuar trajnimin me temë “Procedura dhe objekti i Konfliktit Administrativ”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me procedurën dhe objektin e konfliktit administrativ.

Në pjesën e parë të këtij trajnimi u trajtuan: dispozitat ligjore për procedurën në konfliktin administrativ dhe objekti i konfliktit administrativ. Në pjesën e dytë u trajtuan: procedura ligjore në Departamentin për çështje administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe përmbarimi i vendimeve të këtij departamenti.

Që në fillim u potencua se konflikti administrativ lind si rrjedhojë e marrëdhënieve juridike administrative në rastin kur me aktin administrativ përfundimtar të organit shtetëror, është shkelur ligji në dëm të personit fizik apo personit juridik. Qëllimi i Ligjit për konfliktet administrative (LKA) është sigurimi i mbrojtjes gjyqësore të të drejtave dhe interesave juridike të personave fizik, juridik dhe palëve të tjera të cilat të drejta dhe interesa janë cenuar me vendime individuale ose me veprime të organeve të administratës publike.

Me aktin administrativ përfundimtar pala e pakënaqur kundër vendimit përfundimtar, nuk mund të përdor mjete të rregullta juridike atëherë lind konflikti midis palës dhe organit të cilin e ka nxjerr aktin administrativ përfundimtar. Ky konflikt lind si rrjedhojë e ligjshmërisë së aktit përfundimtar me të cilin organi shtetëror vendos mbi të drejtën, detyrimin ose interesin juridik të personit fizik apo juridik.

Më tej u potencua se procedura e konfliktit administrativ është e rregulluar me Ligjin nr.03/L-202 me të cilin rregullohen kompetenca, përbërja e gjykatës dhe rregullat e procedurës,

në bazë të të cilave gjykatat kompetente vendosin për ligjshmërinë e akteve administrative me të cilat organet kompetente të administratës publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizik dhe juridik dhe të palëve tjera, si dhe për ligjshmërinë e veprimeve të organeve administrative.

Në vazhdim u konkludua se konflikti administrativ mund të iniciohet vetëm kundër aktit administrativ të nxjerr në procedurën administrative në shkallë të dytë. Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative, nuk është lejuar ankesa. Gjithashtu konflikti administrativ mund të filloj edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës ose ankesës së palës nën kushtet e parapara me LKA.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të teorik, duke u bazuar në raste praktike dhe duke u shoqëruar me diskutime interaktive të lehtësuara nga trajnuesit, përmes analizës dhe shtjellimeve të tematikës, me fokus në procedurën dhe objektin e konfliktit administrativ.

Përfitues ishin gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe të Gjykatës së Apelit.



Program i Specializuar trajnimi për Prokurimin Publik të Kosovës– Sesioni 1

Më 13-14 qershor 2019, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoj trajnimin me temë: “Program i Specializuar Trajnimi për Prokurimin Publik të Kosovës”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me prokurimin publik dhe zbatimin e drejtë të dispozitave lidhur me hetimin dhe gjykimin e veprave penale të kësaj natyre.

Me rastin e këtij trajnimi u trajtuan planifikimi i prokurimit, dosja e tenderit dhe specifikimi teknik duke vënë në pah rëndësinë e prokurimit publik, procedurën e tenderimit dhe lidhjen e

kontratës duke respektuar dispozitat e përgjithshme lidhur me të drejtat e detyrimet të palëve pas lidhjes së kontratës si dhe administrimin e kontratës dhe përzgjedhjen e organit mbikëqyrës.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit patën rastin që përmes rasteve praktike të analizojnë procesin e planifikimit, të zbërthejnë dosjen e tenderit dhe të identifikojnë indikatorët e korrupsionit që lidhen me prokurimin publik.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët dhe prokurorët nga niveli themelor i gjykatave dhe prokurorive.



Kontrata e sigurimit

Më 18 qershor 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme realizoi trajnimin nga fusha ekonomike me temë “Kontrata e sigurimit”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve rreth kontratës së sigurimit në përgjithësi si një nga kontratat më të rëndësishme në qarkullimin civil.

Në kuadër të këtij trajnimi u trajtuan: qëllimet dhe rëndësia e sigurimeve, specifikat e kontratës së sigurimit – kushtet e përgjithshme dhe të veçanta, procedurat për kompensimin e dëmit jashtë procedurës gjyqësore, procedura gjyqësore për kompensimin e dëmit, bazat e përgjegjësisë në rastet e shkaktimit të dëmit,

llojet e kompensimit adekuat në rastet e dëmeve të paraqitura si dhe regresimi i dëmit në rastet e sigurimeve “Kasko”.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive dhe përmes rasteve praktike ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë të nivelit themelor nga Departamenti Ekonomik dhe ai i Përgjithshëm si dhe bashkëpunëtor profesional.



Masat e diversitetit

Më 19 qershor 2019, Akademia e Drejtësisë me mbështetjen e UNICEF-it, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme ka realizuar trajnimin për gjyqtarë dhe prokurorë me temë: “Masat e diversitetit”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve në zbatimin e Kodit të Drejtësisë për të Mitur, veçanërisht në definimin e kushteve dhe situatave specifike për shqiptimin e drejtë të masave të diversitetit

Gjatë këtij sesioni u trajtua legjislacioni vendor, me theks të veçantë Kodi i Drejtësisë për të Mitur, në të cilin u vunë në pah mangësitë dhe problemet në zbatimin praktik të masave të diversitetit veçanërisht të masave të reja të cilat kanë hyrë në fuqi. Në këtë kontekst u diskutua

pëlqimi i të miturit për shqiptim të masës së diversitetit, prezenca e të miturit, prindit dhe mbrojtësit në seancë për shqiptim të masës së diversitetit, si dhe marrja e aktvendimit për shqiptimin e masave të diversitetit. Gjithashtu, vëmendje të veçantë iu kushtua vlerësimit të masave adekuate për situatat specifike dhe identifikimi se ndaj kujt dhe për çfarë vepra mund të shqiptohen masat.

Pjesëmarrësit patën rastin që përmes diskutimeve dhe rasteve nga praktika gjyqësore të identifikojnë dispozitat ligjore adekuate dhe të ofrojnë zgjidhjet e duhura ligjore.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë, prokurorë për të mitur të nivelit themelor



Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale

Më 20-22 qershor 2019, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Departamentin Ligjor i SHBA-së/OPDAT, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë “Kodi Penal dhe Kodin e Procedurës Penale”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që përfituesit e trajnimit të njihen me dispozitat e reja ligjore dhe ato që kanë pësuar ndryshime esenciale me qëllim të zbatimit të drejtë dhe më të lehtë në praktikë.

Për tre ditë me radhë janë trajtuar ndryshimet e dispozitave të përgjithshme të Kodit Penal, duke përfshirë përgjegjësinë penale të personave juridik, dënimin me burgim, ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik, ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës dhe rregullat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimeve, parashkrimi i ndjekjes penale, fillimi dhe ndërprerja e parashkrimit të veprës penale dhe parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve, dispozitat e terrorizmit dhe veprat penale kundër jetës dhe trupit, ngacmimi seksual dhe nenet e tjera të ndërlidhura.

Rëndesi i është kushtuar edhe veprave penale kundër ekonomisë siç janë shmangia nga tatimi, pranimi i paarsyeshëm i dhuratave, dhënia e paarsyeshme e dhuratave, kontrabandimi i

mallrave, shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore ose tarifave akcizore kanë qen pjesë e trajnimit gjithashtu, poashtu edhe veprat penale kundër shërbimeve komunale dhe nenet e reja, veprat penale të korrupsionit zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, mbrojtja e detyruar, mbrojtësi me shpenzime publike, kur mbrojtja nuk është e detyruar dhe të drejtat e të dëmtuarit ose viktimës, hudhja e kallëzimit penal, e drejta për të apeluar hudhjen, masat e veçanta hetimore, marrja në pyetje në procedurë paraprake, deklarata në procedurë paraprake.

Gjithashtu është trajtuar dhe mundësia hetuese e veçantë, hetimet, afati i hetimeve, pushimi dhe rihapja e hetimeve, suspendimi i personit zyrtar nga detyra, marrëveshja për pranimin e fajësisë dhe dëshmitarët bashkëpunues, qasja publike në aktakuzë dhe publikimi i aktgjykimit, provat dhe faktet shtesë, shqyrtimi i dytë, aktakuza e konfirmuar dhe caktimi i shqyrtimit gjyqësor, gjykimi në mungesë, seanca për caktimin e dënimit, standardi i rishikimit të ankesave shkeljet substanciale, ndryshimi i aktgjykimit nga gjykata e Apelit, rigjykimi, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, shkresat - thirrjet elektronike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë, prokurorë dhe avokat nga regjioni i Prishtinës.



Mbrojtja gjyqësore në rast të fyerjes dhe shpifjes

Më 25 qershor 2019, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë “Mbrojtja gjyqësore në rast të fyerjes dhe shpifjes”.

Qëllimi i trajnimit ishte avancimi i shkathtësive profesionale të përfituesve të trajnimit, në zbatimin e drejtë të mbrojtjes gjyqësore në rast të fyerjes dhe shpifjes në pajtim me parimet Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe zbatimin të praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në atë vendore.

Gjatë këtij trajnimi u elaborua korniza ligjore vendore dhe praktika gjyqësore e Kosovës lidhur me fyerjen dhe shpifjen, padia për shpifje dhe fyerje, liria e shprehjes si një nga themelet bazë të një shoqërie demokratike dhe e drejta e qasjes në dokumente publike.

Po ashtu, u trajtua edhe përgjegjësia e gazetarit në publikimin e artikujve dhe zbulimi i burimit të informacionit në rastin e fyerjes dhe shpifjes tek personat me autoritet publikë, si dhe barra e provës në të gjitha veprat për shpifje dhe fyerje. Gjatë këtij trajnimi u vë në pah se i padituri do të ketë barrën e provave për të dëshmuar vërtetësinë e deklaratës së tij dhe konstatimi nga gjykata se një nga deklaratat e fakteve që vihen në dyshim është në thelb e vërtetë, e përjashton të paditurin nga çdo përgjegjësi.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikë gjatë punës së tyre të përditshme.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelore si dhe bashkëpunëtor profesional.



E drejta për një proces të rregullt gjyqësor– Neni 6 i KEDNJ

Më 26 qershor 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV-së, ka realizuar trajnimin me temë “E drejta për një proces të rregullt gjyqësor– neni 6 i KEDNJ”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me rolin, kërkesat dhe detyrimet nga neni 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ) - e drejta për një proces të rregullt ligjor.

Në pjesën e parë të këtij trajnimi u trajtuan: Nocionet dhe kategoritë që përmban neni 6 i KEDNJ, mbrojtjet procedurale sipas dispozitave të këtij neni të KEDNJ. Në pjesën e dytë u trajtuan: pavarësia dhe paanshmëria e gjykatave në kontekst të këtij neni dhe standardet dhe kërkesat që përmban neni 6 i KEDNJ.

Në këtë trajnim u potencua se GJEDNJ e ka interpretuar në mënyrë të zgjeruar këtë nen me arsyetimin se interpretimi i zgjeruari i nenit 6 është me rëndësi themelore për funksionimin e demokracisë. Në rastin *Delcourt* kundër Belgjikës, gjykata deklaroi se: “në një shoqëri demokratike brenda kuptimit të Konventës, e drejta për një ushtrim të rregullt të drejtësisë, zë një vend kaq të rëndësishëm, sa që një interpretim i kufizuar i nenit 6 par.1 nuk do t’i korrespondonte synimet dhe qëllimit të asaj dispozite”.

Gjithashtu u konkludua se kërkesat dhe garancitë e parapara me nenin 6 të Konventës, paraqesin detyrë për çdo gjyqtar dhe prokurorë të sigurojë, respektimin e tyre gjatë gjithë procesit gjyqësor, dhe jo vetëm gjatë këtij procesi gjyqësor, por edhe në të gjitha fazat që e paraprinë dhe e pasojnë atë. Neni 6 deklaron të drejtën e secilit për një seancë të drejtë gjyqësore, duke përfshirë të drejtën e tij për qasje në gjykatë, për një seancë në prezencën e të akuzuarit, një të drejtë për mos-vet inkriminim, barazia në mjete, e drejta për seancë gjyqësore me palë kundërshtuese, dhe një gjykim i arsyeshëm. Të gjitha këto janë parime, të drejta dhe detyra të gjykatësit të sigurojë për një palë në një proces gjyqësor.

Sipas interpretimit të GJEDNJ çdo gjykatë duhet të veprojë në mënyrë të tillë që në dhënien e drejtësisë të shfaqë paanësinë e saj. Vihet theksi mbi këtë pikë sepse paanësia e gjyqtarit është një karakteristikë mjaft e rëndësishme e procesit të rregullt gjyqësor e cila gjendet e bazuar qoftë në ligje kombëtare, ashtu dhe ato ndërkombëtare. Përveç paanësisë element i rëndësishëm që lidhet ngushtë me të është edhe pavarësia e gjyqtarit në procesin gjyqësor.

Me rastin e këtij trajnimi pjesëmarrësit patën rastin që përmes detyrave të ndara në grupe të zbërthejnë praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së me fokus në zbatimin e drejtë të një procesi të rregullt ligjor konform KEDNJ-së.

Përfituesit: gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës dhe bashkëpunëtorët profesional.

Shkathtësitë e përfaqësimit në gjykim

Më 26-28 qershor 2019, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme realizoi trajnimin me temë “Shkathtësitë e përfaqësimit në Gjykim”.

Qëllimi i trajnimit ishte avancimi i shkathtësive praktike të teknikave adekuate të përfaqësimit gjatë gjyqimit.

Në kuadër të këtij trajnimit u trajtuan: marrja e drejtpërdrejtë në pyetje si një komunikim i rrjedhshëm dhe i qartë i temës së rastit dhe baza ligjore për teknikën e marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje, duke përdorur pyetjet e arta të kriminalistikës, më ç ‘rast u zhvillua simulim i marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje nga pjesëmarrësit të ndarë në grupe punuese.

Gjatë trajnimit po ashtu u trajtua edhe baza ligjore sa i përket marrjes së tërthortë në pyetje, si një mjet për marrje në pyetje nga pala tjetër me qëllim të prezantimit të fakteve të mira dhe vënia në pah të dobësive të palës tjetër. Pjesë e diskutimeve në këtë fazë të trajnimit ishin edhe udhëzimet për zbatim në praktikë të marrjes së tërthorët. Gjithashtu edhe për këtë teknikë pjesëmarrësit u ndanë në grupe dhe zhvilluan simulim të marrjes së tërthorët në pyetje.

Në pjesën e fundit të trajnimit u zhvillua simulim gjykimi me qëllim të demonstrimit të përdorimit të këtyre teknikave në një gjykim.

Përfitues të këtij trajnimit ishin gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit themelor.



Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale

Më 27-29 qershor 2019, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Ambasadën e SHBA-së (Departamenti Ligjor i SHBA-së), ka realizuar trajnimin e radhës me temë “Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale” .

Qëllimi i këtij trajnimi ishte njohja e gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe profesionistëve tjerë ligjor nga regjioni i Prishtinës me dispozitat e reja ligjore të Kodit Penal për zbatimin e drejtë të tyre në praktikë.

Gjatë trajnimit për tre ditë me radhë janë trajtuar ndryshimet legislative duke analizuar ndryshimet që kanë të bëjnë me veprat penale kundër shërbimeve komunale, veprat penale të korrupsionit zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare dhe nenet e reja që janë përfshirë në Kodin Penal i cili ka hyr në fuqi.

Vëmendje të veçantë i është kushtuar edhe

ndryshimeve që priten të bëhen në Kodin e Procedurës Penale, siç është mbrojtja e detyruar, mbrojtësi me shpenzime publike, kur mbrojtja nuk është e detyruar dhe të drejtat e të dëmtuarit ose viktimës, hudhja e kallëzimit penal, e drejta për të apeluar hudhjen, masat e veçanta hetimore, marrja në pyetje në procedurë paraprake, deklarata në procedurë paraprake dhe mundësia hetuese e veçantë.

Po ashtu u diskutua dispozita e re që rregullon suspendimin e personit zyrtar nga detyra, qasja publike në aktakuzë dhe publikimi i aktgjykimit, gjykimi në mungesë si dhe seanca për caktimin e dënimit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtar, prokuror, avokat dhe mbrojtës të viktimave nga regjioni i Prishtinës.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar

Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar (gjenerata e VII)

Në kuadër të programit të trajnimeve fillestare për gjyqtarët e sapo emëruar (gjenerata e VII), gjatë muajit qershor janë realizuar 16 sesione trajnuese nga moduli: “E drejta civile, administrative dhe ekonomike”

Nga nën moduli: E drejta e detyrimeve – pjesa e parë janë realizuar tetë (8) sesione trajnuese ku u trajtuan: Nocioni, karakteristikat dhe klasifikimi i detyrimeve, Kontratat e detyrimeve, Shuarja e kontratave, Mbajtja e përjetshme, Kontrata mbi dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë, Shkaktimi i dëmit si burim i detyrimeve, Shpërblimi i dëmit, Shpërblimi i dëmit të pësuar në aksidentet në punë.

Nga nën moduli: “E drejta e pronësisë dhe të drejtat tjera të përafërta – pjesa e dytë janë realizuar tetë (8) sesione trajnuese dhe janë diskutuar këto çështje: E drejta e pronësisë,

Bashkëpronësia dhe pronësia e përbashkët, Mënyrat e fitimit të drejtës së pronësisë -Fitimi derivativ të drejtës së pronësisë, Mënyra origjinere e fitimit të drejtës së pronësisë, Mbrojtja gjyqësore e të drejtës së pronësisë, Padia negatore edhe mbrojtja e posedimit, Të drejtat sendore në sendet e huaja, vërtetimi, konstituimi dhe ndërprerja e servituteve sendore, dhe mbrojtja e servituteve sendore.

Ndërsa komponenta e trajnimit praktik, për këtë periudhë është realizuar përmes vijimit të praktikës nga ana e gjyqtarëve të sapoemëruar në gjykatat përkatëse konform orarit të përcaktuar me program. Trajnimin fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar janë duke e ndjekur (39) gjyqtarë të sapo emëruar, shtatë (7) prej të cilëve janë të komunitetit serb .



Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për prokurorët e sapo emëruar

Në kuadër të trajnimit fillestar për prokurorët e sapo emëruar gjenerata e VIII (tetë), gjatë muajit qershor janë realizuar gjithsejtë 8 (tetë) sesione trajnuese nga moduli: “Kodi Penal i



Republikës së Kosovës.

Nga nën moduli “Kodi Penal-pjesa e përgjithshme” janë realizuar 4 (katër) sesione trajnuese në të cilat janë trajtuar temat: Nocioni dhe elementet e veprës penale, objekti dhe subjekti i veprës penale, ndarja e veprave penale si dhe veprimi.

Objektivë e këtij nën moduli ishte zgjerimi i

njohurive lidhur me funksionimin dhe sistemin e sanksioneve penale si dhe karakteristikat kryesore të ekzekutimit të vendimeve.

Në kuadër të nën modulit “Kodi Penal-pjesa e veçantë” janë realizuar 4 (katër) sesione trajnuese ku prokurorët e sapo emëruar kanë zhvilluar kompetencën profesionale mbi këto çështje: Veprat penale nga kapitulli XIV, XV dhe hyrje në kapitullin e XVI, Veprat penale kundër jetës dhe trupit dhe lirive e të drejtave të njeriut, Veprat penale nga kapitulli XVII dhe XX, Veprat penale nga kapitulli XX.

Ndërsa komponenta e trajnimit praktik, për këtë periudhë është realizuar përmes vijimit të praktikës nga ana e prokurorëve të sapoemëruar në prokuroritë përkatëse, konform orarit të përcaktuar me program.

Trajnimin fillestar për prokurorët e sapo emëruar janë duke e ndjekur 12 prokurorë të sapo emëruar.



Aktivitetet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Menaxhimi i dosjes në sistemin gjyqësor dhe prokurorial

Më 20-21 qershor 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, në bashkëpunim me UNDP, realizoi trajnimin me temë “Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin gjyqësor dhe prokurorial”.

Qëllimi i këtij sesi trajnues ishte ngritja e njohurive të pjesëmarrësve rreth rregulloreve dhe praktikave ligjore të aplikueshme në menaxhimin e rrjedhës së rasteve në gjykata dhe prokurori.

Në kuadër të këtij trajnimi janë trajtuar: regjistrat e gjykatave dhe prokurorive,

organizimi i rrjedhës së punës dhe zhvillimit të lëndës, mbledhja e të dhënave statistikore dhe raportimi, menaxhimi efikas i lëndëve bazuar në metodologjinë CEPEJ, digjitalizimi i procesit të punës në gjykata dhe prokurori.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial duke përfshirë: bashkëpunëtor profesional, zyrtarët ligjor, ndihmës administrator, referentë dhe referentë të lartë.



Aktivitetet tjera

Nënshkrimi i memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Akademisë së Drejtësisë, GIZ-it dhe Autorëve

Prishtinë, më 10 qershor 2019, Është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet GIZ, Autorëve të botimit “Udhëzuesi për Procedurën Administrative” dhe Akademisë së Drejtësisë për transferimin e të Drejtave të Pronësisë dhe të Drejtave Tjera të Autorit.

z. Valon Kurtaj- Drejtor Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë theksoi se ky transferim i këtyre të drejtave në pronësi të Akademi të Drejtësisë është i një rëndësie të veçantë dhe njëherit falënderoi autorët dhe GIZ-in për bashkëpunimin.

z. Karl Weber nga Agjencioni Gjerman për

Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ)- Projekti për Reforma Ligjore dhe Administrative potencoi se ky projekt ka për qëllim të mbështes procesin e reformës ligjore dhe administrative të Kosovës.

Publikimi i botimit “Udhëzuesi për Procedurën Administrative” u mundësua nga GIZ dhe me rastin e nënshkrimit të memorandumit të mirëkuptimit autorët e këtij udhëzuesi z. Hasan Shala- Kryetar i Gjykatës së Apelit dhe znj. Delushe Halimi, u shprehën të kënaqur me kalimin e këtyre të Drejtave tek Akademia e Drejtësisë.



Punëtori: Ngritja e aftësive ligjor për gjyqtarët

Më 11-14 qershor 2019 në Budvë të Malit të Zi, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV), në mbështetje të OSBE-së ka realizuar një punëtori për gjyqtarët e regjionit të Mitrovicës me temë: Ngritja e aftësive ligjore të gjyqtarëve.



Në hapje të këtij trajnimit në fillim mori fjalën Ilija Bundaleski Drejtor regjional i Misionit të OSBE-së në Mitrovicë, i cili theksoi rëndësinë e kësaj punëtorie e cila është përqendruar në risit e Kodit Penal dhe dispozitat e reja që kanë prekur veprën penale të korrupsionit zyrtar dhe kundër detyrës zyrtare e po ashtu edhe tek dhuna në familje dhe ngacmimit seksual. Në vazhdim mori fjalën Kryetari i Gjykatës Supreme i cili në fjalën e tij hyrëse ju drejtuar pjesëmarrëseve në cilësinë e anëtarit të Këshillit Drejtues të Akademisë, duke falënderuar dhe mbështetur fuqishëm bashkëpunimin e vazhdueshëm të Akademisë së Drejtësisë dhe OSBE –së.

Më pas mori fjalën Nikolla Kabashiq, Kryetar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë i cili në fjalën e tij mes tjerash falënderoi OSBE-në për kontributin e dhënë në sundimin e ligjit. Në fund të pranishmëve iu drejtua Afërdita Bytyqi, Kryetare e Gjykatës Themelore të Prishtinës, duke përkrahur organizimin e punëtorisë dhe

duke theksuar rëndësinë e diskutimit sa i përket dispozitave të ndryshuara me Kodin e Ri Penal. Gjatë kësaj punëtorie në ditën e parë kryesisht është diskutuar për standardet e të drejtave të njeriut dhe garancitë për një gjykim të drejtë si dhe gjykimi brenda kohës së arsyeshme dhe kërkesave të tjera nga kapitulli 23 dhe 24 i Acquis të BE-së, kushtet për pranim në Bashkim Evropian. Diskutimi është zhvilluar rreth obligimit të gjyqtarëve për të gjykuar drejtë me kujdes dhe me urgjencë si dhe ka vazhduar me sfidat rreth arsyetimit të vendimeve gjyqësore. Më tej, është diskutuar rreth mjeteve të jashtëzakonshëm juridike si dhe kërkesa pasurore juridike.

Në vazhdim të kësaj punëtorie janë identifikuar ndryshimet në Kodin Penal sa i përket dënimeve tek veprat penale kundër detyrës zyrtare si dhe tek vepra penale e konfliktit të interesit lidhur me dënushmerinë ku Kodi i Ri Penal parasheh dënim komulativ dhe si subjekt të procedurës njehë edhe anëtarin e familjes së personit zyrtar. Gjithashtu janë trajtuar edhe ndryshimet në kapitullin e veprave penale kundër integritetit seksual këto ndryshime janë bërë në nenet e mëparshme 228,230 dhe 243. Këto nene përveç që janë ndryshuar në substance kanë pësuar edhe ndryshime teknike dhe gjuhësore, që kanë qenë pjese e diskutimit të kësaj punëtorie.

Po ashtu janë trajtuar edhe zhvillimet e fundit në hartimin e amendamenteve të Kodit të Procedurës Penale, ndryshimet dhe risitë që priten të ndodhin.

Përfitues të kësaj punëtorie kanë qenë gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Regjionit të Mitrovicës dhe Prishtinës.

Sjellja brenda dhe jashtë zyrës si dhe ndërgjegjësimi social dhe përgjegjësia

Me 14 qershor 2019 Akademia e Drejtësisë në mbështetje të projektit nga GIZ, në kuadër të profesioneve të lira ka realizuar trajnimin dedikuar zyrtarëve të Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas me temë: “Sjellja brenda dhe jashtë zyrës si dhe ndërgjegjësimi social dhe përgjegjësia”



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të zyrtarëve të Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas rreth sjelljeve brenda dhe jashtë zyrës si dhe rreth ndërgjegjësimit social dhe përgjegjësive për zbatimin e drejtë të parimeve

dhe sjelljeve etike.

Gjatë këtij trajnimi janë elaboruar një varg situatash të cilat tregojnë sjelljen e drejtë dhe të duhur me theks të veçantë shfrytëzimi i rrjeteve sociale, mënyra e shfrytëzimit, sjelljet etike sociale brenda dhe jashtë zyrës dhe çështje tjera të cilat në rast të mosrespektimit dëmtojnë imazhin dhe besimin e publikut në institucionet e drejtësisë.

Trajnimi është zhvilluar në mënyrë interaktive me bashkëbisedim mes trajnuesve dhe pjesëmarrësve, e po ashtu pjesëmarrësit patën rastin përmes detyrave dhe rasteve studimore të identifikojnë sjelljet jo etike dhe etike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin zyrtarët ligjor nga Agjencia për Ndhimë Juridike Falas nga gjitha regjionet e Kosovës.

Zgjedhja e problemeve dhe konflikteve si dhe komunikimi ndërpersonal

Me 15 qershor 2019 Akademia e Drejtësisë në mbështetje të projektit nga GIZ, në kuadër të profesioneve të lira ka realizuar trajnimin dedikuar zyrtarëve të Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas me temë: “Zgjidhja e problemeve dhe konflikteve si dhe komunikimi ndërpersonal”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të zyrtarëve ligjor rreth shmangies nga situatat e mundshme konfliktuozë të cilat interferojnë negativisht në shërbimet e ndihmës juridike falas.

Gjatë trajnimit janë trajtuar konfliktet dhe përkufizimi teorik, problemet dhe barrierat tjera në punë, marrëdhëniet ndërnjerëzore dhe ndërkollegiale në punë, mandati formal dhe përgjegjësia individuale ndaj rrethit në punë si

dhe ruajtja dhe mbrojtja nga mobingu.

Me rastin e këtij trajnimi përmes rasteve praktike janë elaboruar situata të ndryshme rreth menaxhimit dhe zgjidhjes së problemeve të mundshme në funksion të mbështetjes së punës dhe rritjes së efikasitetit të punës së Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas gjatë ushtrimit të detyrave dhe funksionit të përcaktuara me ligj.

Trajnimi është zhvilluar në mënyrë interaktive me bashkëbisedim mes trajnuesit dhe pjesëmarrësve, e po ashtu pjesëmarrësit patën rastin përmes detyrave dhe rasteve studimore të ofrojnë zgjidhjet e duhura dhe etike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin zyrtarët ligjor nga Agjencia për Ndhimë Juridike Falas nga gjitha regjionet e Kosovës.

Tryezë diskutimesh e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit

Më 17-19 qershor 2019 në Durrës të Shqipërisë, Akademia e Drejtësisë në mbështetje të UN ka realizuar një tryezë diskutimesh me gjyqtarët e Gjykatës së Apelit.



Qëllimi i kësaj tryeze ishte unifikimi i praktikës së Gjykatës së Apelit në procesin e bërjes së drejtësisë veçanërisht në çështjet që janë në kompetencë të divizionit civil.

Me rastin e kësaj tryeze janë diskutuar çështjet që kanë të bëjnë me kontestet për kompensimin e pagave me rastin e pensionimit të shërbimit civil, rastet kur gjykata e shkallës së parë të shpallet jo kompetente territoriale sipas detyrës zyrtare, rastet e shqyrtimit paraprak të padisë, kompetenca për vendosje rreth kërkesave të palëve për shlyerjen e borxhit ndaj KEDS/KEK, kompetenca e gjykatës për vendosje në procedurën kontestimore ose jo kontestimore me rastin e shpronësimit të patundshmërisë edhe

për dëmin e shkaktuar jashtë pronësisë së eksproprijuar, cilësia e dokumentit përmbarues, aktvendimi i inspektoratit të punës, për pagat jubilarë dhe për përcjellje në pension, aprovimi i kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit material të shkaktuar me rastin e aksidenteve në komunikacion kur nuk ka prova shkresore si dhe vërtetimi i gjendjes faktike përmes ekspertizës kur ekspertizat janë kundërthënëse.

Nga diskutimet lidhur me çështjet e lartpërmendura është vërejtje se kolegjet nuk kanë pasur praktikë të unifikuar dhe pothuajse edhe në këtë mënyrë kjo praktikë në disa raste ka kaluar instancat. Lidhur me këtë nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit u vendosë që për çështjet që kishte interpretime të ndryshme të kërkohet mendimi juridik i Gjykatës Supreme.

Në cilësi të monitoruesve të kësaj tryeze ishin edhe përfaqësues nga Akademia e Drejtësisë të cilët problemet e theksuara në tryezë do ti kenë parasysh gjatë hartimit të programit trajnues dhe do ti publikojnë shumë shpejt në faqen zyrtare të Akademisë.

Pjesëmarrës të kësaj tryeze kanë qenë gjyqtarët e Gjykatës Apelit, Departamenti i Përgjithshëm, përkatësisht divizioni civil si dhe nga Departamenti Ekonomik dhe Administrativ.



<https://ad.rks-gov.net>

**Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës**

**Tel: + 381 38 200 18 660
Fax: + 381 38 512 095
E-mail: infoad@rks-gov.net**